

## KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

### Sesioni 2, Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Tema: “Zgjidhja e çështjeve ligjore në sajë të ndërmjetësimit”

**Ndërmjetësimi** është një shërbim me rëndësi të konsiderueshme për lehtësimin e barrës së gjyqësorit. Duke marrë parasysh faktin që Shqipëria vitet e fundit është gjetur shpesh në shkelje të Nenit 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, për tejzgjatje të proceseve të arsyeshme ndërgjegjësimit rreth këtij shërbimi duhet ti kushtohet vëmendje. Kjo për arsye se ky është një shërbim relativisht i ri në vendin tonë dhe besueshmëria ndaj tij akoma nuk është e fortë.

**Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve** është njohur si ent publik në vitin 2013. Kjo nënkupton faktin se ky organizëm kryen një funksion me rëndësi publike dhe veprimtaria e tij i nënshtrohet kontrollit të parashikuar për organet e administratës publike. Ky shërbim mund të ofrohet ekskluzivisht vetëm nga ky organizëm. Një ndër parimet e funksionimit të tij është “Autonomia”, që nënkupton se ky organ ka diskrecionin të nxjerrë urdhra, udhëzime për rregullimin e veprimtarisë së tij dhe të vetëfinancohet. Megjithatë në fillim të veprimtarisë mbështetet edhe në financimet shtetërore. Efikasiteti i këtij shërbimi qëndron në faktin se është shumë i shpejtë, më pak formal dhe me kosto të ulët. Gjithashtu ndërmjetësimi jo domosdoshmërisht janë juristë rrjedhimisht për çështje teknike mund të zgjidhet një ndërmjetës i fushës përkatëse, gjithmonë nga lista e ndërmjetësve të licencuar.

#### *Probleme dhe Rekomandime:*

- **Informimi dhe rritje e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi ndërmjetësimin** 0Duhet rritur aktiviteti sensibilizues, fushatat ndërgjegjësuese dhe informuese për të dhënë informacionin e duhur rreth ndërmjetësimit, do të ndihmojë gjithashtu në përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Informimi është me rëndësi pasi me këtë individ kupton që ka dhe alternativa të tjera për të zgjidhur mosmarrëveshjet.
  - a) Të dizajnohet **fushata informuese me përfshirjen e mediave** dhe përcaktimin e target grupeve. Për këtë është i rëndësishëm dhe bashkëpunimi me Median e shkruar dhe audiovizive, që mund të përcjellë informacionin e duhur. Gjithsesi është e rëndësishme që gjatë këtij procesi media të respektojë disa kushte dhe rregulla që lidhen me ligjin e Ndërmjetësimit. Nga ana tjetër një promovim cilësor i

ndërmjetësimi i bën qytetarët të mendojnë pozitivisht për këtë procedurë dhe ta vlerësojnë si një zgjedhje të mirë. Për më shumë ndërgjegjësim dhe informim sugjerohet përgatitja e kurrikulave për trajnimin, publikimi i broshurave apo materialeve të tjera informuese

b) **Përmirësimi i bashkëpunimit mes institucioneve mbi procedurat dhe mekanizmat e referimit** duke marrë për bazë strategjitë dhe praktikën më të mira edhe nga vende të tjera më të zhvilluara në këtë drejtim me anë rekomandimesh dhe analizash.

- **Konsolidimi i kuadrit ligjor** - Qëllimi kryesor i këtij komponenti është identifikimi dhe analizimi i hapësirave në legjislacion dhe se si mund të përafrohen ato me ligjin evropian. Është mjaft i rëndësishëm promovimi i Ndërmjetësimi, të sigurohet akses i lirë në sistemin gjyqësor si dhe të bëhet një harmonizim i ligjit për ndërmjetësimin me ligjet dhe kodet e tjera shqiptare: si Kodi Civil, Penal apo i Familjes. Gjithashtu zhvillimi i mëtejshëm i ndërmjetësimi është në një linjë me vetë Reformën në Drejtësi.

a) **Zbatimi i ligjit nr. 10385/2011** nuk ka arritur qëllimin e tij. Ligji është një përkthim i thjeshtë i Direktivës 2008/52/EC “Mbi disa aspekte të ndërmjetësimi në çështjet civile dhe tregtare”, duke mos analizuar praktikën e ndërmjetësimi në Shqipëri. Pavarësisht përpjekjeve ndër vite për të fuqizuar këtë institut, nuk është arritur të bëhet e mundur **zbatueshmëria efektive e tij në praktikë**.

b) Ligji nr. 10385/2011, i ndryshuar **nuk është harmonizuar** me pjesën tjetër të legjislacionit, kryesisht me Kodet, pasi këto akte nuk i japin hapësirën e duhur ndërmjetësimi. Kjo bën që edhe **praktika gjyqësore të kufizohet** në njohjen dhe zbatimin e institutit të ndërmjetësimi

- **Trajnimi i shumë aktorëve që marrin pjesë në procesin e ndërmjetësimi.** Trajnimi është i rëndësishëm pasi rrit ndërgjegjësimin, aftësitë dhe kapacitetet. Me shumë rëndësi është dhe financimi i këtyre trajnimeve pasi kostoja mbetet e madhe si në kohën e harxhuar ashtu dhe në të mira materiale. Trajnimi ndihmon edhe në specializimin te një fushë e caktuar. Grupet që duhen trajnuar janë:
  - **Ndërmjetësit dhe trajnuesit e ndërmjetësve.**
  - **Gjykatësit, punonjës të tjerë në sistemin e drejtësisë dhe zyrat e asistencës ligjore.** Në shumicën e rasteve edhe këtyre aktorëve u mungon informacioni i duhur mbi ndërmjetësimin. Nëse ata do të pajisen me dije mbi procedurat dhe avantazhet e tij, mund t’i orientojnë më mirë qytetarët për zgjidhjen e disa konflikteve të caktuara.
  - **Policia e Shtetit.** Policia e shtetit është shumë faktor i rëndësishëm pasi është i pari që bie në kontakt me publikun dhe mund të informojë dhe t’i bindë që mosmarrëveshjet mes tyre të zgjidhen me anë të ndërmjetësimi.
  - **Ekspertë të tjerë** si psikologë, sociologë, operatorë biznesi, administratë publike etj.

- Ngrija e një **baze të dhënash elektronike** dhe regjistrimit të ndërmjetësuesve, me të dhënat përkatëse të kontaktit. Gjithashtu kjo databazë do të kthehet në trurin e vetëm të DHKN-së. Aty do regjistrohen edhe çështjet për çdo ndërmjetës, që po zgjidhen apo janë zgjidhur.
- **Gjykatat** nuk janë treguar aktive duke thirrur ndërmjetësuesit për t'u adresuar atyre zgjidhjen e disa lloj çështjeve të caktuara, veçanërisht ato të karakterit familjar dhe pasuror. Gjykatat nga ana e tyre nuk orientojnë individët/ palët në zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve të tyre, duke e bërë këtë një normë të detyrueshme në veprimtarinë e gjyqësorit. Nuk janë plotësuar ende dispozitat e KPC që lidhen me ndërmjetësimin.
- **Përfshirje më e madhe** e shoqërisë civile dhe OJF-ve të ndryshme në fushën e ndërmjetësimit.
  - OJF të shumta mund të shërbejnë **si një rezervë për ndërmjetës të rinj** duke rritur cilësinë dhe numrin e ndërmjetësve në Shqipëri.
  - Për të ulur kostot e institucioneve shtetërore dhe për një performancë më të mirë OJF-të duhet të vlerësohen edhe si bashkëpunëtoare që mund të ndihmojnë në **organizimin e trajnimeve, konsultimeve dhe workshopeve** të ndryshëm në kuadër të procesit të trajnimit të ndërmjetësuesve dhe konsolidimit të DHKN-së.
  - Shoqëria Civile duhet të përfshihet edhe **për të dhënë ekspertizën e saj në rishikimin e legjislacionit** që rregullon ndërmjetësimin, aktivitetet, mekanizmat dhe procedurat e tij.
  - Ato janë më të pritura **të ofrojnë shërbime falas**, duke ndikuar pozitivisht në përfshirjen më të madhe të qytetarëve që zgjedhin ndërmjetësimin si rrugën për të zgjidhur situata konfliktuale.
- **Forcimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit në Shqipëri**-Një Dhomë Ndërmjetësimi e qëndrueshme mund të arrihet me realizimin e disa praktikave të rëndësishme. Është një institucion i ri i themeluar përpara 2 vitesh, që ka një kuadër ligjor mjaft të qartë me strukturën dhe statutin e saj. Gjithsesi vërehen disa problematika të DHKN-së si:
  - Mungesa e një **buxheti të konsoliduar** dhe jo të mirëpërcaktuar.
  - Mungesa e **bashkëpunimit të plotë me gjykatat** e rrethetë të ndryshme gjyqësore dhe pamundësia për nënshkrim marrëveshjes me to. Një rast i tillë përmendet me Gjykatën e Beratit.
  - Për një forcim të kapaciteteve të DHKN-së dhe mirëfunksionim të saj u sugjerua edhe një **standardizim i dokumentacionit**.
  - Krijimi i një **regjistri elektronik të dhënash si për ndërmjetësit ashtu** edhe për çështjet që gjykohen dhe zgjidhen nga ata. Kjo do të ndihmojë në koordinim më të mirë të punës dhe vlerësim të arritjeve dhe problematikave të tjera.

*Pjesëmarrës në Sesionin e 2, të Grupit të Punës I:*

**Institucione Shtetërore:**

**Drejtoria e Integritit, Ministria e Drejtësisë- Znj. Tetis Lubonja**

**Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit:**

Znj. Drita Avdyli

Znj. Vjola Godo

Znj. Ilda Gjebrea

Znj. Armelina Lila

Znj. Brunilda Laze

Znj. Enila Hasani

Znj. Iris Çekani

**Ministria e Drejtësisë e Finlandës:**

Znj. Kati Kivisto

Z. Martin Kvocik

**Projekti i Binjakëzimit - Znj. Marjo Naapi**

**Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Z. Elvis Zerva**

**Ministria e Arsimit dhe Sportit - Znj. Erjona Bezalliu**

**Shoqëri Civile dhe institucione:**

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit- Znj. Vjollca Meçaj**

**Këshilli i Europës- Znj. Ina Veleshnja**

**Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë- Znj. Antuela Male**

**KRIIK – Z. Reald Keta**

**Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri- Znj. Majlina Mamushi (Saraçi)**

**Dhoma e Tregtisë- Z. Nikolin Jaka**

**Ndërmjetësues:**



Znj. Alketa Elezi

Z. Loren Liço

Z. Qerim Ismeni

**Akademia dhe Media:**

**Akademia:**

Z. Anton Gurra,

Znj. Sajmira Kopani, **Fakulteti i Drejtësisë, UT**

Znj. Aida Gugu

Z. Eltion Meka, **UNYT**

**Media:**

**Hermes News.al**- Znj. Doriana Matollari

**TVSH**